



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 05- 284

Podujevë,

18.08.2017

Bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032 si dhe në Udhëzimin Administrativ Nr.22/2013, Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, Drejtoria e Arsimit në Podujevë shpallë:

## KONKURS PLOTËSUES

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) TË GJIMNAZEVE DHE TË SHKOLLAVE PROFESIONALE PËR VITIN SHKOLLOR 2017/2018

### 1. Shkolla e Mesme e Lartë Teknike “ Fan S. Noli “ Podujevë

Nr.	Drejtimit	Nr. i klasave	Gjithsejtë nxënës	Vitet e shkollimit
<b>1.</b>	<b>Elektroteknikë-Profilet:</b>			
	Informatikë	2	51	2+1
	Telekomunikacion	2	34	2+1
	Postë dhe telekomunikacion	1	7	2+1
	Energjetikë	1	27	2+1
	Instalues elektrikë	1	28	2+1
<b>2.</b>	<b>Transport dhe trafik-Profilet:</b>			
	Transport rrugor	1	10	2+1
<b>3.</b>	<b>Ndërtimtari-Profilet:</b>			
	Arkitekturë	1	19	2+1
<b>4.</b>	<b>Makineri-Profilet:</b>			
	Saldator	1	32	2+1
	Automatikë	2	53	2+1
	Instalimi ngrohjes dhe kanalizimit	1	16	2+1
<b>5</b>	<b>Tekstil-Profilet:</b>			
	Rrobaqepësi	1	19	2+1
<b>6</b>	<b>Druri-Profilet:</b>			
	Përpunim druri	1	32	2+1
	<b>Gjithsejtë:</b>	<b>15</b>	<b>328</b>	

## **1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt**

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor 2017/2018, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e IX-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

## **2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim**

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe shkolla profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)

Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe Certifikatën e lindjes.

## **3. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve**

Paraqitja e dokumenteve për shkolla profesionale për vitin shkollor 2017/2018, bëhet më datat 21, 22 dhe 23 gusht 2017 në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 8.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën 25.08.2017.

Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHT - komisionit për ankesa.

### **A. Kriteret për regjistrim**

**Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:**

- |   |                      |
|---|----------------------|
| <b>1. Suksesi nga shkollimi i obliguar</b>      | <b>(25%) 25 pikë</b> |
| <b>2. Suksesi nga lëndët prioritare në test</b> | <b>(15%) 15 pikë</b> |
| <b>3. Numri i pikëve nga testi</b>              | <b>(60%) 60 pikë</b> |

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë **100** pikë.

**1.** Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl. 6,7,8,9) mund t'i fitojë maksimalisht 25 pikë.

Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është:

$$\frac{\text{Suksesi (kl.6 + kl.7 + kl.8 + kl.9)}}{4} \times 5 = 25$$

2. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i lëndëve prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 15 pikë (p.sh 3 lëndë të profilit të caktuar shumëzohet me mesataren e notave të kl. 6 – 9 të (5+5+5+5) = 20; 20 : 4 = 5)

$$\frac{\text{mesatarja e lëndës (I) + mesatarja e lëndës (II) + mesatarja e lëndës (III)}}{3} \times 3 = 15 \text{ pikë}$$

Kur në profilin e caktuar kërkohen vetëm dy lëndë atëherë: 2 X 5 = 10 në këtë rast vlera e fituar shumëzohet me 1.5.

$$\frac{\text{mesatarja e lëndës (I) + mesatarja e lëndës (II)}}{2} \times 3 = 15 \text{ pikë}$$

### 3. Kriteri i suksesit të notave në lëndët prioritare për drejtimet përkatëse:

- **Gjimnazi i përgjithshëm** - Mesatarja e lëndëve: gjuhë amtare dhe matematikë së paku duhet të jetë 4 (katër) si dhe 40% të pikëve të testit (40 pikë)
- **Gjimnazi i gjuhëve** - Mesatarja e lëndëve: gjuhë amtare dhe gjuhë angleze, së paku duhet të jetë 4 (katër) si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (10 pikë nga lëndët gjuhë amtare dhe gjuhë angleze)
- **Gjimnazi i shkencave natyrore** - Mesatarja e lëndëve: fizikë, kimi, biologji së paku duhet të jetë 4 (katër), ky kriter vlen edhe për të gjitha profilet e shkollës së mjekësisë. si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (10 pikë nga lëndët fizikë, kimi dhe biologji)
- **Gjimnazi i shkencave shoqërore** - Mesatarja e lëndëve: histori, gjeografi, edukatë qytetare së paku duhet të jetë 4 (katër) si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (10 pikë nga lëndët histori dhe gjeografi)
- **Gjimnazi matematikë - informatikë** - Mesatarja e lëndëve: matematikë, teknologji informative së paku duhet të jetë 4 (katër) si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (10 pikë nga lëndët e matematikës)

p.sh për tri lëndë:  $\frac{\text{Kimi (3) + Biologji (4) + Fizikë (5)}}{3} = \frac{3+4+5}{3} = \frac{12}{3} = 4$

për dy lëndë:  $\frac{\text{Matematikë (3) + T.Informative (5)}}{2} = \frac{3+5}{2} = \frac{8}{2} = 4$

B. Përmbajtja e testit – numri i kërkesave (pyetjeve) sipas lëndëve:

#### I. Gjimnazi i gjuhëve

1. Gjuhë shqipe

20 pikë

2. Gjuhë angleze 5 pikë (Gjithsej 25 pikë)

**II. Shkencat shoqërore:**

1. Gjeografi 12 pikë
2. Histori 13 pikë  
(Gjithsej 25 pikë)

**III. Matematikë**

1. Matematikë 20 pikë
2. informatikë 5 pikë  
(Gjithsej 25 pikë)

**IV. Shkencat natyrore:**

1. Fizikë 9 pikë
2. Kimi 8 pikë
3. Biologji 8 pikë (Gjithsej 25 pikë)

Renditja e lëndëve me prioritet sipas drejtimeve të gjimnazeve:

- I. **Gjimnazi i përgjithshëm:**
  1. Të gjitha pikët e fituara nga testi.  $100 \times 0.6 = 60$  pikë  
**Totali = 60 pikë**
- II. **Gjimnazi matematikë- informatikë:**
  1. Matematikë dhe informatikë 25  $25 \times 1.2 = 30$  pikë
  2. Shkencat natyrore 25  $25 \times 0.6 = 15$  pikë
  3. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25  $25 \times 0.4 = 10$  pikë
  4. Shkencat shoqërore 25  $25 \times 0.2 = 5$  pikë  
**Totali = 60 pikë**
- III. **Gjimnazi shkencat e natyrës:**
  1. Shkencat e natyrës 25  $25 \times 1.2 = 30$  pikë
  2. Matematikë dhe Informatikë 25  $25 \times 0.6 = 15$  pikë
  3. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25  $25 \times 0.4 = 10$  pikë
  4. Shkencat shoqërore 25  $25 \times 0.2 = 5$  pikë  
**Totali = 60 pikë**
- IV. **Gjimnazi i gjuhëve:**
  1. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25  $25 \times 1.2 = 30$  pikë
  2. Shkenca shoqërore 25  $25 \times 0.6 = 15$  pikë
  3. Matematikë dhe Informatikë 25  $25 \times 0.4 = 10$  pikë
  4. Shkenca natyrore 25  $25 \times 0.2 = 5$  pikë  
**Totali = 60 pikë**
- V. **Gjimnazi shoqëror:**
  1. Shkenca shoqërore 25 pikë  $25 \times 1.2 = 30$
  2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 pikë  $25 \times 0.6 = 15$
  3. Matematikë dhe Informatikë 25 pikë  $25 \times 0.4 = 10$

4. Shkenca natyrore 25 25 x 0.2 = 5 pikë  
**Totali = 60 pikë**

Kriteri i lëndëve prioritare nga testi për gjimnaze dhe shkolla të mesme të mjekësisë është minimumi 40% ose 10 pikë.

P.sh. Pikët (Fizikë + Biologji + Kimi) = min.10 pikë  
 Pikët ( Matematikë + T. informative) = min. 10 pikë

5. Renditja e lëndëve me prioritete sipas profileve në shkolla profesionale

- I. Shëndetësi, Bujqësi dhe Veterinari**
- |                                      |                         |
|--------------------------------------|-------------------------|
| 1. Shkencat natyrore 25              | 25 x 1.2 = 30 pikë      |
| 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 | 25 x 0.6 = 15 pikë      |
| 3. Matematikë dhe Informatikë 25     | 25 x 0.4 = 10 pikë      |
| 4. Shkencat shoqërore 25             | 25 x 0.2 = 5 pikë       |
|                                      | <b>Totali = 60 pikë</b> |
- II. Makineri, Elektroteknikë, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë dhe Komunikacion, Kimi – Teknologji**
- |                                      |                         |
|--------------------------------------|-------------------------|
| 1. Matematikë dhe Informatikë 25     | 25 x 1.2 = 30 pikë      |
| 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 | 25 x 0.6 = 15 pikë      |
| 3. Shkenca natyrore 25               | 25 x 0.4 = 10 pikë      |
| 4. Shkenca shoqërore 25              | 25 x 0.2 = 5 pikë       |
|                                      | <b>Totali = 60 pikë</b> |
- III. Ekonomi**
- |                                      |                         |
|--------------------------------------|-------------------------|
| 1. Matematikë dhe informatikë 25     | 25 x 1.2 = 30 pikë      |
| 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 | 25 x 0.6 = 15 pikë      |
| 3. Shkenca shoqërore 25              | 25 x 0.4 = 10 pikë      |
| 4. Shkencat natyrore 25              | 25 x 0.2 = 5 pikë       |
|                                      | <b>Totali = 60 pikë</b> |
- IV. Juridik**
- |                                      |                         |
|--------------------------------------|-------------------------|
| 1. Shkencat shoqërore 25             | 25 x 1.2 = 30 pikë      |
| 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 | 25 x 0.6 = 15 pikë      |
| 3. Matematikë dhe Informatikë 25     | 25 x 0.4 = 10 pikë      |
| 4. Shkenca natyrore 25               | 25 x 0.2 = 5 pikë       |
|                                      | <b>Totali = 60 pikë</b> |
- V. Tregti, Hotelieri dhe Turizëm**
- |                                      |                         |
|--------------------------------------|-------------------------|
| 1. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 | 25 x 1.2 = 30 pikë      |
| 2. Shkenca shoqërore 25              | 25 x 0.6 = 15 pikë      |
| 3. Matematikë dhe Informatikë 25     | 25 x 0.4 = 10 pikë      |
| 4. Shkenca natyrore 25               | 25 x 0.2 = 5 pikë       |
|                                      | <b>Totali = 60 pikë</b> |

**Kriteret për gjimnazin e shkencave shoqërore dhe gjuhësore( për shkollat pilot ).**

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë 100 pikë.

1. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm ( kl. 6,7,8,9) mund t'i fitojë maksimalisht 25 pikë.

Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është:

$$\frac{\text{Suksesi (kl.6 + kl.7 + kl.8 + kl.9)}}{4} \times 5 = 25$$

2. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i lëndëve prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 15 pikë.

Për këtë gjimnaz merren 5 lëndë me prioritet: gjuhë amtare, gjuhë angleze, histori, gjeografi dhe edukatë qytetare.

$$\frac{\text{mes.gj.amtare} + \text{mes.gj.ang.} + \text{mes.his} + \text{mes.gjeo.} + \text{mes.ed.qytet.}}{5} \times 3 = 15 \text{ pikë}$$

4. Renditja e lëndëve me prioritet sipas drejtimeve të gjimnazeve:

Gjimnazi shoqëroro-gjuhësor:

- |  |    |                                   |
|--|----|-----------------------------------|
| 1. Gjuhë amtare, gjuhë angleze dhe shkenca shoqërore | 50 | $50 \times 0.9 = 45 \text{ pikë}$ |
| 2. Matematikë dhe Informatikë                        | 25 | $25 \times 0.4 = 10 \text{ pikë}$ |
| 3. Shkenca natyrore                                  | 25 | $25 \times 0.2 = 5 \text{ pikë}$  |

Totali = 60 pikë

Kriteri i lëndëve prioritare nga testi për gjimnaze dhe shkolla të mesme të mjekësisë është minimumi 40% ose 10 pikë.(në rastin e këtij drejtimi 20 pikë )

$$50 \times 0.9 = 45 \text{ pikë}$$



Drejtori  
Avni Maloku